



[www.d4d-ks.com](http://www.d4d-ks.com)  
Democracy for Development  
Demokraci për zhvillim  
Demokratija za razvoj



# ***E ardhmja e politikës së zgjerimit të BE-së në **Balkanin Perëndimor** pas Merkelit***

***Analizë e Politikave***

Shtator 2021

***E ardhmja e politikës  
së zgjerimit të BE-së  
në Ballkanin Perëndimor  
pas Merkelit***



Copyright © 2021. Demokraci për zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përveç citimit të pjesëve të shkurta për qëllime të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk bën të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem arkivimi, apo të transmetohet në çfarëdo forme apo çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistrues ose tjetërfare, pa lejen paraprake të D4D-së.

Autor: Bodo Weber

Redaktore: Therese Coen, DPC Editorial Board

Ky dokument është prodhuar nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) në bashkëpunim me Democratization Policy Councili (DPC), si pjesë e projektit "Rruga Dytësore drejt Evropianizimit: Një qasje partneriteti", mbështetur nga Fondacionet për Shoqëri të Hapur.



# ***Tabela e përmbajtjes***

Përmbledhja ekzekutive .....	7
Hyrje: Zgjedhjet parlamentare gjermane – fundi i epokës së Merkelit .....	10
<b><i>I. Merkeli, BE-ja dhe Ballkani Perëndimor: lidërshipi reaktiv dhe mbajtja gjallë e perspektivës së anëtarësimit</i></b> .....	
Merkeli udhëheq BE-në në Ballkanin Perëndimor .....	13
Kufizimet e rolit udhëheqës të Merkelit .....	15
<b><i>II. Kriza e Perëndimit dhe nxitja e shkëmbimit territorial: beteja kundër implodimit të zgjerimit</i></b> .....	
Kontrolli i dëmit, parandalimi i katastrofës .....	17
Dështimi për të komunikuar: Merkeli dështon ta bëjë Macronin për vete (dhe anasjelltas) .....	19
Zbehja e fuqisë dhe ndikimit të Merkelit .....	21
<b><i>III. E ardhmja e zgjerimit pas Merkelit</i></b> .....	22
Përfundime dhe rekomandime .....	24



## **Përmbledhja ekzekutive**

Pas zgjedhjeve parlamentare të shtatorit në Gjermani, Kancelarja Angela Merkel do të largohet nga detyra pas një dekade e gjysmë gjatë së cilës ajo jo vetëm që dominoi skenën politike në Gjermani dhe në Evropë, por mori edhe rolin drejtues në politikën e zgjerimit të Bashkimit Evropian karshi Ballkanit Perëndimor. Merkel ishte figurë qenësore për të mbajtur gjallë perspektivën e anëtarësimit të vendeve në valën e rritjes së "lodhjes nga zgjerimi" brenda Bashkimit Evropian (BE), si në Gjermani ashtu dhe brenda partisë së saj të Unionit Demokristian (CDU), dhe pas krizës së Eurozonës në vitin 2009. Gjatë kohës sa mbajti detyrën, ajo ndërmori disa nisma, e ndër më të spikaturat ishte dialogu politik Kosovë-Serbi (2012-2013) dhe Procesi i Berlinit 2014 (në vazhdim), që synojnë nxitjen e bashkëpunimit rajonal. Të dyja ndërmarrjet dolën nga zona e saj e komfortit të kujdesshëm e reaktiv. Me kalimin e kohës, megjithatë, ato arritje u vënë nën llupë, duke u prekur si nga zhvillimet e mëdha të jashtme ashtu edhe nga mangësitë e saj.

Të parat përfshijnë tri ngjarje të mëdha ndërkombëtare të viteve 2015-2016 – kriza evropiane e refugjatëve, referendumi i Brexitit dhe fitorja e Donald Trumpit në zgjedhjet presidenciale në ShBA – të cilat pasqyruan krizën e shtuar të Perëndimit dhe të rendit liberal botëror. Të tjerat kanë të bëjnë me stilin e lidhshimit të Merkelit, që më së miri karakterizohet si reaktiv dhe menaxherial me mungesë të strategjive të politikave apo vizionit. Stili i lidhshimit të Merkelit gjithnjë e më shumë vuri kufizime të vetimponuara në rolin e saj drejtues në BE, i cili përfundimisht u mbështet për muri gjatë krizës së refugjatëve. Mes trazirave të brendshme të BE-së pas vitit 2015, politika e BE-së ndaj rajonit të Ballkanit Perëndimor në fakt nxitu paqëndrueshmëri, duke e detyruar Merkelin dhe qeverinë e saj të kalojnë në kontrollin e dëmit dhe modusin e parandalimit të fatkeqësive. Ato luftuan kundër mbështetjes së shefes së atëhershme të politikës së jashtme të BE-së, Federica Mogherini, për një marrëveshje të shkëmbimit territorial në dialogun Kosovë-Serbi që çoroditi arsyeshmërinë dhe arritjet fillestare të dialogut politik, dhe u përballën me rrezikimin e perspektivës së zgjerimit që vinte nga Emmanuel Macroni, nëpërmjet bllokimit të tij të vazhdueshëm të hapjes së negociatave të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë në BE. Ndikimi i këtyre zhvillimeve la gjurmët e tij në epokën e Merkelit, duke e lënë atë pothuajse duarbosh në angazhimin e saj në Ballkanin Perëndimor. Largimi i saj nga skena politike kërkon një vlerësim të thuktë të politikave të BE-së dhe Gjermanisë në një dekadë e gjysmë, duke ofruar mundësinë për një riangazhim të politikës gjermane ndaj rajonit dhe rolit kryesor të Gjermanisë në zgjerimin brenda BE-së. Ekziston një konsensus i gjerë mes analistëve dhe politikëbërësve në Berlin se të Gjellbrit, të cilët sipas sondazheve të fundit kanë shans të mirë për të pasur rol vendimtar në qeverinë e ardhshme gjermane, janë më të përshtatshmit për të mbushur boshllëkun e lënë pas Merkelit dhe për të shfrytëzuar mundësinë në dritën e ndryshimit të ardhshëm në Zyrën e Kancelarit.

## Rekomandime

Ky dokument është shkruar me fokus te publiku kosovar. Së këndejmi, ndërsa grupi i parë i rekomandimeve ka për qëllim politikën gjermane për tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor, i dyti i drejtohet posaçërisht Prishtinës.

### *Qeverisë së ardhshme gjermane*

Për të shmangur kolapsin përfundimtar të politikës së zgjerimit të BE-së dhe për të rikthyer politikën e saj drejt Ballkanit Perëndimor, koalicioni i ardhshëm qeveritar gjerman duhet të ndërmarrë një varg hapash vendimtarë politikë në fillim të mandatit të vet, veçanërisht në vitin 2022:

- Berlioni duhet të nisë negociatat serioze me anëtarët e BE-së, duke filluar me Parisin, për reformën e ardhshme të brendshme të BE-së për të përfshirë propozimet e veta me fokus të veçantë të të ashtuquajturat shtetet anëtare joliberalë në të cilat ekziston kriza e sundimit të ligjit dhe demokracisë,
- Nga fillimi i vitit 2022, veçanërisht pas zgjedhjeve presidenciale franceze, Berlioni do t'i duhet të angazhohet seriozisht me Parisin për të ardhmen e zgjerimit, për zhblokimin e negociatave të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë dhe për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës,
- Qeveria e re gjermane dhe partitë e saj në pushtet duhet t'u komunikojnë qytetarëve se është në interesin më të mirë të Gjermanisë të hapë zgjerimin drejt vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe se është e pashmangshme që BE-së do t'i duhet të ndërmarrë njëkohësisht reformën e brendshme dhe zgjerimin,
- Berlioni do të duhet të trajtojë ngecjen demokratike në vendet e Ballkanit Perëndimor duke forcuar sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit në politikën e zgjerimit të BE-së,
- Berlioni duhet të ndërmarrë një nismë brenda Këshillit Evropian për një strategji afatgjatë të politikave të BE-së për Bosnjë dhe Hercegovinën, me ndryshimet kushtetuese në thelbin e saj,
- Berlioni duhet të kapë nismën dhe t'i drejtohet administratës së Bidenit në fillim të vitit 2022 për hartimin e një strategjie të re transatlantike të Ballkanit Perëndimor që përfshin zgjerimin e BE-së dhe NATO-s,



- Berlina duhet t'i drejtohet administratës së Bidenit në fillim të vitit 2022 për një nismë të përbashkët për të rifilluar negociatat Kosovë-Serbi për të arritur një marrëveshje përfundimtare, gjithëpërfshirëse brenda një kornize negociuese të bazuar në parimet burimore të dialogut politik 2012-2013.
- Berlina duhet t'i nxisë anëtarët për të rikthyer besueshmërinë e politikës së zgjerimit të BE-së dhe perspektivës së anëtarësimit, dhe pastaj të ringjallë Procesin e Berlinit si mjet për të nxitur bashkëpunimin rajonal që nuk kufizohet vetëm brenda projekteve të infrastrukturës, si dhe ta ruajë lidhshypin gjerman në këtë proces.

### *Qeverisë së Kosovës*

Në dritën e ndryshimit të ardhshëm në udhëheqjen gjermane, qeveria kosovare duhet të përgatitet për të avokuar dhe për t'u angazhuar në mënyrë efektive me qeverinë e re gjermane për të avancuar interesat e Kosovës dhe rajonit më të gjerë të Ballkanit Perëndimor:

- Prishtina duhet t'i drejtohet herët koalicionit të ri qeverisës në Berlin për të avokuar për vazhdimësinë e udhëheqjes gjermane të BE-së sa i përket politikës së zgjerimit karshi Ballkanit Perëndimor.
- Prishtina duhet të sigurojë që avokimi i saj i vazhdueshëm në kryeqytetet e BE-së – për të zhblokuar liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës menjëherë pasi zgjedhjeve presidenciale franceze – t'u përshtatet specifikave të situatës pas Merkelit në Gjermani dhe Bashkim Evropian.
- Prishtina duhet të avokojë që Kancelari dhe qeveria e ardhshme të marrin iniciativën, së bashku me Presidentin Biden dhe administratën e tij, për të rinisur negociatat për një marrëveshje përfundimtare, gjithëpërfshirëse me Serbinë, të bazuar në parimet dhe synimet e përcaktuara qartë.
- Nëse rinisin negociatat, Prishtina duhet të sinjalizojë gatishmërinë e saj për të bërë kompromis me Beogradin në këmbim të garancive të Gjermanisë dhe ShBA-së se marrëveshja do të çojë në sovranitet të plotë dhe integritet territorial të Kosovës dhe në përparim thelbësor në arritjen e subjektivitetit të plotë ndërkombëtar të bazuar në bashkëpunim dhe mbështetje proaktive të Beogradit.

## ***Hyrje: Zgjedhjet parlamentare gjermane – fundi i epokës së Merkelit***

Këtë muaj, qytetarët gjermanë do t'ia mësyjnë kutive të votimit për të zgjedhur anëtarët e rinj të parlamentit federal, dhe duke vepruar kështu do të përcaktojnë indirekt koalicionin e ardhshëm qeverisës. Ndërsa sondazhet tregojnë qartë se nuk do të ketë shumicë për koalicionin e tanishëm, është e qartë se forma e qeverisë së re do të jetë dukshëm më ndryshe. Por ka një arsyeshmëri tjetër për këtë këndvështrim: Ndër Spitzenkandidaten<sup>1</sup> të ndryshëm, gjegjësisht përfaqësues të partive që garojnë për t'u bërë kancelari i ardhshëm gjerman, për herë të parë në një dekadë e gjysmë mungon një emër – Angela Merkel. Pasi shërbeu për katër mandate (16 vjet), Kancelarja konservatore do të dalë në pension në fund të vitit/fillimit të vitit të ardhshëm, në varësi të asaj se sa shpejt mund të bëhet koalicioni i ri qeverisës.

Gjatë asaj periudhe të gjatë në pushtet, Merkeli jo vetëm që u bë personaliteti dominues në Unionin Demokratik (CDU) dhe në politikën gjermane, por u bë edhe figura politike dominuese në skenën evropiane (dhe për Evropën në skenën globale), duke menaxhuar Bashkimin Evropian (BE) gjatë krizave të ndryshme, disa prej të cilave ishin ekzistenciale: Eurozona dhe kriza ekonomike globale, kriza e Ukrainës, kriza evropiane e refugjatëve dhe të tjera. Njëkohësisht, Merkeli mori rolin drejtues në politikën e zgjerimit të BE-së karshi Ballkanit Perëndimor. Ajo ishte figurë qenësore për të mbajtur gjallë perspektivën e anëtarësimit të vendeve mes rritjes së "lodhjes nga zgjerimi" brenda BE-së. Përveç kësaj, ajo ndërmori dhe lehtësoi disa nisma të rëndësishme duke përfshirë dialogun politik Kosovë-Serbi 2012-2013 dhe Procesin e Berlinit 2014 që synon nxitjen e bashkëpunimit rajonal.

Largimi i kancelares Merkel nga skena politike padyshim se do të lërë një hendek në politikën e Ballkanit Perëndimor të Gjermanisë dhe BE-së, duke shtruar pyetje serioze në lidhje me të ardhmen e politikës së zgjerimit të BE-së. Kjo vlen posaçërisht në dritën e zhvillimeve negative në politikën e BE-së karshi rajonit të cilat janë shpalosur gjatë pesë viteve të fundit: shtytja drejt një marrëveshjeje të rrezikshme të shkëmbimit territorial në negociatat e udhëhequra nga BE-je për një marrëveshje përfundimtare dhe gjithëpërfshirëse midis Kosovës dhe Serbisë; bllokimi i hapjes së negociatave të anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë nga disa shtete anëtare të BE-së, të udhëhequr nga Presidenti francez Emmanuel Macron; dhe hapat për të pranuar forcimin e mëtejshëm të dominimit etnopolitik në Bosnjë dhe Hercegovinë (BeH).

---

<sup>1</sup> Spitzenkandidaten është termi gjerman për kandidatët kryesorë të partive garuese në zgjedhjet parlamentare. Në zgjedhjet parlamentare gjermane ata janë gjithashtu kandidatë për kancelar të ardhshëm.

Ky punim shtjellon rolin që kancelarja Merkel luajti në politikën e zgjerimit të BE-së karshi Ballkanit Perëndimor dhe ndikimin e mundshëm të largimit të saj, me një fokus të veçantë te Kosova dhe dialogu Kosovë-Serbi. Ai bazohet në hulumtimet afatgjata të autorit mbi politikat e Gjermanisë dhe BE-së në Ballkanin Perëndimor, dhe në intervistat me politikëbërësit gjermanë dhe evropianë, zyrtarë qeveritarë dhe ekspertë të ndryshëm, të realizuara gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit. Pjesa e parë shtjellon udhëheqjen e kancelares Merkel në politikën e integritit në BE – natyrën e rolit të saj udhëheqës, duke përfshirë arritjet dhe kufizimet. Pjesa e dytë analizon përmbysjen e politikës së BE-së karshi Ballkanit Perëndimor pas vitit 2016, kur në sfondin e krizave të ndryshme të brendshme BE-ja filloi të nxisë de fakto paqëndrueshmërinë në rajon dhe perspektiva e anëtarësimit u vu në pikëpyetje. Pjesa e tretë vlerëson ndikimin e mundshëm të largimit politik të Merkelit në politikat e Gjermanisë dhe BE-së karshi Ballkanit Perëndimor. Pjesa e fundit nxjerr disa përfundime dhe jep rekomandime si për qeverinë e ardhshme gjermane ashtu edhe për qeverinë kosovare.

## ***Merkeli, BE-ja dhe Ballkani Perëndimor: lidershipi reaktiv dhe mbajtja gjallë e perspektivës së anëtarësimit***

Pas stabilizimit fillestar të pasluftës të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe hapjes së perspektivës së anëtarësimit në BE për vendet e rajonit në Samitin e Selanikut 2003, Shtetet e Bashkuara (ShBA), të preokupuara me Afganistanin dhe Irakun, në vitin 2005 ia dorëzuan BE-së lidershpin perëndimor në Ballkanin Perëndimor. BE -ja, e cila thjesht kishte bartur politikën e saj ekzistuese të zgjerimit dhe arkën e veglave nga Evropa Qendrore dhe Lindore në rajonin jo të ngjashëm të Evropës Juglindore pa analiza apo strategji serioze, për vite me radhë nuk kishte arritur të merrte në mënyrë efektive atë lidhshp të trashëguar. Në BeH, kalimi i keqlogaritur drejt një politike më praktike dhe mbyllja e Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë (OHR) (atëherë e planifikuar në mënyrë jorealiste për vitet 2006-2007) shpejt hasi në probleme. Përpjekjet e ndërmjetësimit ndërkombëtar që synonin zgjidhjen e kontestit Kosovë-Serbi dështuan, duke rezultuar në shpalljen e pavarësisë të mbështetur nga Perëndimi në vitin 2008 – nisma e fundit e udhëhequr nga ShBA-të në Ballkanin Perëndimor për dekadën që po vinte. Nga ana e BE-së, pas krizës ekonomike në Eurozonë dhe botë në vitin 2009, politika e zgjerimit drejt Ballkanit Perëndimor – korniza e deklaruar për vazhdimin e transformimit demokratik të vendeve – u fut në krizë. Mes trazirave të brendshme në BE, dhe me kujtesën e përvojës së tmerrshme të raundit të pranimit të vitit 2007 (Rumania dhe Bullgaria) në mendjen e të gjithëve, "lodhja nga zgjerimi" u përhap në mesin e shteteve anëtare të BE-së dhe politika e zgjerimit drejt Ballkanit Perëndimor u fut në "autopilot burokratik".<sup>2</sup>

Ky ishte sfondi kundrejt të cilit Kancelarja gjermane Angela Merkel, e cila mori detyrën në vitin 2005, gradualisht mori drejtimin e BE-së për zgjerimin dhe çështjen më të gjerë të politikës së BE-së ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor.

<sup>2</sup> Kurt Bassuener, Bodo Weber, "Are We There Yet? International Impatience vs. a Long-term Strategy for a Viable Bosnia," DPC Policy Brief, May 2010, p. 3, gjendet në: <http://www.democratizationpolicy.org/pdf/policybrief1.pdf>.

## **Merkeli udhëheq BE-në në Ballkanin Perëndimor**

Merkeli dhe qeveria e saj mbrojtën politikën e zgjerimit të BE-së drejt Ballkanit Perëndimor dhe mbajtjen gjallë të ofertës së anëtarësimit të vitit 2003. Merkeli konsideronte se Evropa nuk do të ishte e plotë dhe e lirë pa vendet e Ballkanit, dhe se vendet e përfshira në luftërat ballkanike të viteve 1990 nuk mund të stabilizohen në mënyrë të qëndrueshme, dhe kështu të pushojnë së përbëri kërcënim sigurie për BE-në pa integrim në BE. Ajo gjithashtu iu kundërvu rezistencës ndaj zgjerimit brenda partisë së saj, veçanërisht në grupin CDU në Parlamentin Evropian, por edhe në partinë simotër bavareze, Unioni Kristian Social (CSU), i cili për një kohë kishte avokuar për një "Evropë të krishterë", me çka nënkuptohej kufizimi i zgjerimit deri te vendi që ishte më afër anëtarësimit, gjegjësisht Kroacia kryesisht katolike<sup>3</sup>. Berlino nxiti fuqishëm forcimin e kushtëzimit të reformës që bëri që Kroacia të ishte vendi i parë kandidat që do të përballlej me zbatimin e njëkohshëm të dy kapitujve të negociatave të pranimit – Kapitullit 23 dhe 24 që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit.<sup>4</sup> Ky fuqizim i kushtëzimit ishte një mësim i nxjerrë nga integrimi i Rumanisë dhe Bullgarisë dhe kompromiset që bëri BE-ja në lidhje me sundimin e ligjit, veçanërisht luftën kundër korrupsionit, në proceset e pranimit të këtyre dy vendeve.

Por kjo gjithashtu i ofroi një mënyrë Merkelit për të kundërshtuar skepticizmin e zgjerimit mes shteteve të tjera anëtare, dhe brenda partisë së saj.

Kancelarja Merkel gjithashtu ndërmori nismën për disa çështje të pazgjidhura politike në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht për kontestet e pazgjidhura të statusit, më i rëndësishmi mes tyre kontesti Kosovë-Serbi. Përballë trazirave të dhunshme të verës së vitit 2011 në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe dhe përplasjes me forcat e KFOR-it të udhëhequra nga NATO-ja, të komanduar më pas nga një gjerman, duke përfshirë një breshëri plumbash drejt ushtarëve gjermanë të KFOR-it, Merkeli konfirmoi lidhësin.<sup>5</sup>

Gjatë një vizite shtetërore në Beograd në gusht të vitit 2011, në një konferencë të përbashkët shtypi me Presidentin e atëhershëm serb Boris Tadiq, Merkeli bëri të ditur fillimin e një kursi të ri politik të BE-së karshi Serbisë për Kosovën. Aty kushtëzoheshin aspiratat e Serbisë për anëtarësim me miratimin e një politike të bazuar në realitetin e Kosovës: njohjen e humbjes së Kosovës si bazë për normalizimin gradual të marrëdhënieve me ish-krajinën e saj të kthyer në shtet të pavarur. Ky ndryshim politik i dha fund tolerancës së BE-së ndaj Tadiqit dhe politikës së qeverisë të udhëhequr nga Partia Demokratike e "BE-së dhe Kosovës" – politikë krejtësisht joreale që synon shmangien e trajtimit të çështjes së kontestueshme kosovare brenda vendit. Ky ndryshim bazohej në shantazhimin e Tadiqit nga BE-ja me kërcënimin se nëse do t'i bëhej shumë presion Kosovës, qeveria e tij proevropiane do të rrezikonte humbjen e pushtetit nga forcat nacionaliste të epokës së Millosheviqit.

---

<sup>3</sup> "Frieden und Stabilität für den Westbalkan," available at: <https://www.bundesregierung.de/breg-de/suche/westbalkan-gipfel-1939554>.

<sup>4</sup> Intervista me politikëbërës gjermanë, Berlin 2009-2013.

<sup>5</sup> Bodo Weber, "A Date for Belgrade? Conditionality, German Leadership and Serbia's Path to the EU," DPC Policy Paper, Berlin, June 2013, gjendet në: <http://www.democratizationpolicy.org/pdf/serbiapolicy.pdf>.

Kështu, Merkeli mori përsipër një rrezik të madh të prishjes me ata që konsideroheshin aleatë politikë demokratikë të Perëndimit në Serbi. Ndryshimi i politikës së saj karshi Kosovës vërtet kontriboi në humbjen e pushtetit të qeverisë së Tadiqit në vitin 2012 kundrejt një koalicioni të partive që ishin në pushtet në vitet 1990 – Partia Socialiste Serbe (SPS) dhe Partia Progresive Serbe (SNS), parti e shkëputur nga Partia Radikale Serbe. Megjithatë, me mbështetjen nga ShBA-të dhe Mbretëria e Bashkuar, gjatë viteve 2012–2013 Zyra e Kancelares së Merkelit arriti të nisë dialogun politik të udhëhequr nga BE-ja mes Kosovës dhe Serbisë dhe të negociojë një përparim historik fillestar me Marrëveshjen e Prillit të vitit 2013. Duke u bazuar në një kornizë negociuese me parime dhe vija të kuqe të përcaktuara qartë (edhe pse ende pjesërisht të nënkuptuara), duke përfshirë edhe Merkelin që deklaroi: “koha e ndryshimeve të kufijve në Ballkan ka mbaruar”<sup>6</sup>, lidhshipi gjerman shtyu një ndryshim historik të politikës në Beograd, ndërsa Kryeministri i atëhershëm Ivica Daçiq i tha opinionit serb se duhet të përballet me realitetin se Serbia e ka humbur Kosovën dhe nuk do ta kthejë mbrapsht. Ky sukses i evropianizimit fillestar të politikave të dikurshme të partive nacionaliste mundësoi ngritjen e Aleksandar Vuçiqit në udhëheqjen e SNS-së dhe të politikës serbe. Ndër sukseset e dukshme të lidhshipit të Merkelit ishte arritja e mbështetjes së të gjitha shteteve anëtare të BE-së për ndryshimin e politikës së saj – përfshirë pesë vendet e BE-së që ende nuk e kanë njohur Kosovën.<sup>7</sup> Kjo erdhi pas vitesh të inercisë në të cilën BE-ja mbeti pasive në kontestin Kosovë-Serbi në dritën e ndarjeve të saj të brendshme pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Një nismë tjetër e madhe e Merkelit është i ashtuquajturimi Procesi i Berlinit. I nisur në Samitin e Berlinit në gusht të vitit 2014 dhe më pas i organizuar nga shtetet e tjera anëtare të BE-së në kryeqytetet e tyre përkatëse, ky proces ka bashkuar Gjashtëshen e Ballkanit Perëndimor (WB6) që aspironjë anëtarësimin dhe vendet anëtare të BE-së të përkushtuara për zgjerimin e BE-së, plus institucionet e ndryshme të BE-së, me qëllim të nxitjes së bashkëpunimit rajonal. Procesi u ndoq së bashku me mekanizmat e BE-së dhe përfshiu disa shtete anëtare të BE-së. Ai u mundësua nga dialogu politik i cili përfshiu takime të rregullta midis zyrtarëve shtetërorë kosovarë dhe serbë dhe çoi në një zbutje të përgjithshme të marrëdhënieve ndërpersonale midis krerëve të shteteve dhe qeverive në Ballkanin Perëndimor.<sup>8</sup>

Për më tepër, Procesi i Berlinit u konceptua si një mekanizëm për të nënvizuar dhe ringjallur perspektivën e anëtarësimit të aspirantëve të Ballkanit Perëndimor në mes të skepticizmit të vazhdueshëm për zgjerimin që vinte nga disa anëtarë të BE-së. Format i fillimisht mundësoi përparim qenësor të bashkëpunimit rajonal midis WB6-shit, ndryshe nga dhjetëra nisma të ngjashme të nisura gjatë një dekade e gjysmë të cilave u mungonte vullneti politik dhe implementimi. Përgjithësisht pranohet se udhëheqja e Merkelit dhe Gjermanisë në Procesin e Berlinit, dhe lidhja e saj me perspektivën e integritimit në BE, sollën ndryshimin.<sup>9</sup>

---

<sup>6</sup> Agron Bajrami, Bodo Weber, “The Original Framework of the Political Dialogue,” KFOS-DPC Policy Note, Prishtina-Berlin, May 2018, available at: [http://www.democratizationpolicy.org/wp-content/uploads/2020/05/1\\_The-Original-Dialogue-Framework\\_English.pdf](http://www.democratizationpolicy.org/wp-content/uploads/2020/05/1_The-Original-Dialogue-Framework_English.pdf).

<sup>7</sup> Intervistë me zyrtarin e qeverisë gjermane, maj 2021.

<sup>8</sup> Intervistë me zyrtarin e qeverisë gjermane, gusht 2014.

<sup>9</sup> Intervista me zyrtarë të qeverisë gjermane, ish-zyrtarë të shteteve të Ballkanit Perëndimor, mars-maj 2021.

## **Kufizimet e rolit udhëheqës të Merkelit**

Kufizimet politike të lidërshiptit të Merkelit ishin mjaft të neglizhuara gjatë atyre viteve të lidërshiptit të fuqishëm në skenën evropiane, që më shumë ishin pasojë e qasjes së saj politike dhe filozofike sesa pasojë e rrethanave të përgjithshme politike. Përkundër themelit të fortë mbi vlerat liberale demokratike të bazuara në edukimin e saj në Gjermaninë Lindore, qasja e politikave të Merkelit ishte kryesisht ajo e një menaxhereje politikash dhe jo një strategeje politike, aq më pak vizionareje. Qasja e saj shkencore, menaxheriale e bëri atë një menaxhere të aftë të krizës, por edhe e kufizoi fushën e udhëheqjes së saj, e cila në radhë të parë ishte reaktive. Merkel reagoi me vendosmëri në situata krize, por vetëm kur mungesa e veprimeve nuk ishte më e realizueshme. Kështu, në BeH, qeveria Merkel fillimisht luajti rol pasiv, madje edhe negativ, brenda BE-së. Nga viti 2009 deri në vitin 2014, Berlioni udhëhoqi kampin e shteteve anëtare brenda një BE-je të ndarë thellësisht, e cila kërkoi të shkëputej nga roli aktiv në BeH – pavarësisht krizës së përshpejtuar strukturore politike që kërcënonte destabilizimin – duke hequr qafe institucionet e Dejtonit me mandat ekzekutiv (OHR dhe EUFOR) që bënin të mundur angazhimin e bashkësisë ndërkombëtare të pasluftës në vend.<sup>10</sup>

Në vitin 2014, Gjermania ra dakord për një nismë kompromisi në BeH me Mbretërinë e Bashkuar, shtetin kryesor<sup>11</sup> të kampit kundërshtar që kërkonte një riangazhim më bindës të BE-së në BeH, të bazuar në realitetin shqetësues politik në terren të shkaktuar nga trazirat e dhunshme shoqërore që shpërthyen në BeH në shkurt. Nisma e profilit të ulët, e zhvendosur siç ishte në menaxhimin e nivelit të mesëm në ministritë e jashtme gjermane dhe britanike (ndryshe nga marrëveshja e prillit e negociuar nga Zyra e Kancelares), dha rezultatet e kufizuara dhe nuk sollën ndonjë ndryshim.<sup>12</sup>

Përkundër përparimit fillestar historik<sup>13</sup> në dialogun politik Kosovë-Serbi, Berlioni nuk arriti të zhvillonte një strategji apo masterplan afatgjatë. Si rrjedhojë, kur vëmendja e Berlinit dhe Zyres së Kancelares u zhvendosën në tema të nxehta globale siç është kriza e Ukrainës ose kriza evropiane e refugjatëve, udhëheqja e dialogut ra në duart e institucioneve të BE-së.

---

<sup>10</sup> Kurt Bassuener, Bodo Weber, "House of Cards: the EU's 'Reinforced Presence' in Bosnia and Herzegovina," DPC Policy Paper, Sarajevo-Berlin, May 2013, gjendet në: <http://www.democratizationpolicy.org/pdf/may.pdf>.

<sup>11</sup> Bassuener/Perry/Vogel/Weber, "Retreat for Progress in BiH? – The German-British Initiative," DPC Policy Paper, Sarajevo-Berlin-Brussels, November 2014, gjendet në: [http://www.democratizationpolicy.org/pdf/DPC\\_Policy\\_Paper\\_-\\_Retreat\\_for\\_Progress\\_in\\_BiH.pdf](http://www.democratizationpolicy.org/pdf/DPC_Policy_Paper_-_Retreat_for_Progress_in_BiH.pdf).

<sup>12</sup> Bodo Weber, "The EU's Failing Policy Initiative for Bosnia and Herzegovina. A Reform Agenda & Questionnaire Monitoring Report," DPC Policy Paper, Berlin, April 2018, available at: [http://www.democratizationpolicy.org/pdf/DPC\\_EU\\_BiH\\_Initiative\\_Failure\\_Policy\\_Paper.pdf](http://www.democratizationpolicy.org/pdf/DPC_EU_BiH_Initiative_Failure_Policy_Paper.pdf).

<sup>13</sup> Përfshin takimet e para të zyrtarëve shtetërorë serbë me homologët e tyre kosovarë, njihjen faktike të pavarësisë së shtetit të Kosovës në Marrëveshjen e Prillit 2013 dhe në deklaratën e intervistës të Kryeministrit të atëhershëm të Serbisë Ivica Dačić të vitit 2013 se Serbia kishte humbur Kosovën. Shih: Bodo Weber, "A Date for Belgrade? Conditionality, German Leadership and Serbia's Path to the EU."

Në mungesë të udhëzimeve nga Berlioni dhe kryeqyteteve të tjera perëndimore se si të veprohet, vakumi strategjik u mbush nga udhëheqës autoritarë në Kosovë dhe Serbi të cilët instrumentalizuan pjesëmarrjen e tyre në dialogun e mbështetur nga Perëndimi dhe perspektivën e integritetit në BE, si burim legjitimiteti të brendshëm, duke vonuar pafund përparimin në dialogun për zbatimin e Marrëveshjes së Prillit<sup>14</sup>. Ndërsa dialogu kaloi në krizë, Vuçiqi nisi transformimin e tij autoritar, dhe më vonë edhe autokratik të shtetit dhe politikës serbe, ndërsa rikthimi i reformave demokratike u përshkallëzua në tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor.

---

<sup>14</sup> Agron Bajrami, Bodo Weber, "The Original Framework of the Political Dialogue."





## ***Kriza e Perëndimit dhe nxitja e shkëmbimit territorial: beteja kundër implodimit të zgjerimit***

Periodha 2015–2016 shënoi goditjen e trefishtë të krizës evropiane të refugjatëve, referendumin e Brexitit në Mbretërinë e Bashkuar dhe fitoren e Donald Trumpit në zgjedhjet presidenciale në ShBA, si dhe rritjen e populizmit nacionalist në tërë Evropën, duke shpërfaqur një krizë besimi në demokracinë liberale në Perëndim dhe në rendin liberal botëror. Gjatë kësaj kohe BE-ja dhe politika e gjerë e Perëndimit ndaj Ballkanit Perëndimor u kaluan nga funksioni i dobët për shkak të mungesës së një vizioni strategjik tek eksportimi efektiv dhe i hapur i paqëndrueshmërisë në rajon përmes mjeteve pasive dhe aktive. Kriza e refugjatëve ia bëri me dije Beogradit dhe kryeqyteteve të tjera të Ballkanit Perëndimor se BE-ja kishte më shumë nevojë për to sesa që ato i duheshin BE-së<sup>15</sup>, ndërsa fitorja e Trumpit ngjalli shpresa tek elitat etnopolitike në rajon për një ringjallje të agjendave të tyre të papërmbushura nacionaliste. Qasja shkallë-shkallë e dialogut politik kishte parashikuar zbatimin e shpejtë të Marrëveshjes së Prillit 2013 dhe pritej të sillte marrëveshje shtesë paralelisht me përparimin në procesin e integritetit të Serbisë (dhe më pas të Kosovës) në BE. Realiteti ishte se dialogu politik, tashmë në krizë, tani ishte mbështetur për muri.

## ***Kontrolli i dëmit, parandalimi i katastrofës***

Realiteti i ri bëri që qeveria e kancelares Merkel të zhvendoste fokusin e zgjerimit dhe politikës së Ballkanit Perëndimor nga mundësimi i përparimit të kontrollit të dëmeve dhe parandalimi i fatkeqësive. Gjatë verës së vitit 2017, ndërsa Gjermania po përgatitej për zgjedhjet parlamentare në shtator dhe Merkel i për mandatin e saj të fundit, institucionet e BE-së u përpoqën të shpëtonin dialogun politik duke hedhur poshtë qasjen e dështuar shkallë-shkallë dhe duke kërcyer të pika përfundimtare, gjegjësisht negociatat për një marrëveshje finale, gjithëpërfshirëse për normalizimin e plotë të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Këto negociata, që tashmë po zhvilloheshin prapa dyerve të mbyllura kur qeveria e re gjermane filloi të funksionojë plotësisht në pranverën e vitit 2018, përveç se u bënë sfidë madhore për rolin drejtues të Berlinit, prishën plotësisht kornizën, parimet dhe qëllimet fillestare të dialogut politik. Në kërkim të një marrëveshjeje, Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Federica Mogherini, dhe ekipi i saj morën kontrollin e negociatave me një qasje transaksionale – se çfarëdo marrëveshje është marrëveshje e mirë. Kjo prishi efektivisht agjendën e BE-së, ndërsa negociatat morën fund dhe u larguan nga kryeqytetet e shteteve anëtare.

<sup>15</sup> Intervistë me zyrtarin e BE –së, Beograd 2017.

Mogherini dhe ekipi i saj nxitën shkëmbim territorial, një marrëveshje në dukje e shpejtë, pa asnjë parim dhe duke shkelur të gjitha ato që ishin artikuluar më parë nga BE-ja dhe Perëndimi për Ballkanin Perëndimor, në bashkëpunim me Presidentin serb Vuçiq, i cili synonte të shmangte marrëveshjen fillestare, politikisht të dhimbshme të dialogut 2012-2013 dhe me Presidentin kosovar Hashim Thaçi, i cili ishte gati të shiste veriun e Kosovës në këmbim të ikjes nga ndjekja penale për krimet e luftës nga Gjykata Speciale në Hagë.<sup>16</sup>

Merkeli dhe qeveria gjermane morën drejtimin për të kundërshtuar lojën e rrezikshme të ekipit të Mogherinit, ku shumica e shteteve anëtare të BE-së kundërshtonin një marrëveshje të shkëmbimit territorial, por shumë pak ishin të gatshëm të shprehnin kundërshtimin e tyre, duke preferuar që Berlini të merrte flamurin. Mbështetja dhe avokimi i Berlinit për një marrëveshje përfundimtare vërtet gjithëpërfshirëse u ndërlikua gjatë majit dhe qershorit të vitit 2018 kur administrata e Trumpit dhe Franca (gjegjësisht Presidenti Macron) zhvendosën politikën e tyre respektive drejt idesë së një marrëveshjeje të shkëmbimit territorial. Në prill të vitit 2019, në mini-samitin Merkel-Macron të Ballkanit Perëndimor në Berlin – kur udhëheqësit e BeH, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut shprehën kundërshtimin e tyre për shkëmbimin territorial dhe Presidenti Macron për herë të parë kundërshtoi idenë dhe konceptin themelor të ndarjes etnoterritoriale – Berlini përfundimisht arriti të ndalte përpjekjet e pamenduara të Mogherinit dhe ekipit të saj.

Rinisja e negociatave, e drejtuar nga Berlini, për një marrëveshje përfundimtare të nisur në vjeshtën e vitit 2019 përpara marrjes së detyrës së Komisionit të ri Evropian, u dëmtua më pas për një vit nga administrata Trump që ringjalli nxitjen e shkëmbimit territorial. I dërguari i Presidentit amerikan Richard Grenell arriti aty ku ekipi i Mogherinit u ndal me iniciativën, madje në mars të vitit 2020 nisi rrëzimin e qeverisë Kurti në Kosovë e cila i kishte rezistuar kësaj initiative. Shtytja e administratës Trump përfundoi vetëm kur Gjykata Speciale në prill të atij viti njoftoi se ishte në pritje të një aktakuze kundër Thaçit.<sup>17</sup>

Ndërsa shtytja për shkëmbim territorial midis Kosovës dhe Serbisë përfundimisht dështoi në vitin 2020, në BeH në qershor të atij viti negociatorët e BE-së dhe ShBA-ve, së bashku me drejtuesit e partive nacionaliste në pushtet, arritën një marrëveshje në qytetin e Mostarit që ndiqte të njëjtin lloj të logjikës politike etnoterritoriale që frymëzoi avokuesit e shkëmbimit territorial, dhe në fakt që nxiti luftërat ballkanike të viteve 1990<sup>18</sup>.

---

<sup>16</sup> Intervista me zyrtarë të qeverisë kosovare dhe diplomatë evropianë, përfshirë disa me qasje në projekt-marrëveshjet e ofruara nga ekipi i Mogherinit, 2018-19.

<sup>17</sup> "Special Court Accuses President Thaçi of War Crimes," Prishtinainsight.com, June 24, 2020, gjendet në: <https://prishtinainsight.com/special-court-accuses-president-thaci-of-war-crimes/>; On the background of the formation of the Specialist Court, shih: Lekë Batalli, "Parallel Justice: A First Test for Kosovo's Specialist Chambers and Specialist Prosecutor's Office," Verfassungsblog.de, March 4, 2019, gjendet në: <https://verfassungsblog.de/parallel-justice-a-first-test-for-kosovos-specialist-chambers-and-specialist-prosecutors-office/>.

<sup>18</sup> Kurt Bassuener, Valery Perry, "Is the US Doubling Down on Division in Bosnia and Herzegovina?," Just Security, March 16, 2021, available at: <https://www.justsecurity.org/75299/is-the-us-doubling-down-on-division-in-bosnia-and-herzegovina/>.

Në dukje, marrëveshja adresonte një ngërç politik disadekadash që e kishte lënë qytetin pa aftësinë për të mbajtur zgjedhje lokale, por vetëm në këmbim të lejimit të partive kryesore kroate dhe boshnjake për të përcaktuar ndarjen etnoterritoriale të Mostarit, duke iu kundërvënë politikave më shumë se dydekadeshe perëndimore të pasluftës që synonin ribashkimin e qytetit të ndarë. E arritur prapa dyerve të mbyllura, marrëveshja i shpëtoi në masë të madhe vëmendjes së Berlinit dhe kryeqyteteve të tjera evropiane dhe perëndimore<sup>19</sup>. Sidoqoftë, ajo krijoi precedent. Që nga fillimi i vitit 2021, negociatorët e BE-së dhe ShBA-ve janë angazhuar në negociata të nivelit shtetëror me partitë etnike në pushtet për të ashtuquajturën reformë të ligjit zgjedhor. Në dukje, negociatat supozohet të kenë të bëjnë me eliminimin e formave të ndryshme ekzistuese të diskriminimit në sistemin zgjedhor shumëetnik të BiH; por në thelb, ato nxiten nga e njëjta qasje ndaj shkëmbimit territorial Kosovë-Serbi, pra negociatorët perëndimorë që synojnë të nënshkruajnë çdo marrëveshje të mundshme duke akomoduar agjendat e paplotësuara nacionaliste, antievropiane dhe antidemokratike të udhëheqësve etnopolitikë<sup>20</sup>. Berlioni luftoi kundër nismave të ndryshme BE-ShBA për të adresuar çështje të hapura, të pazgjidhura në Ballkanin Perëndimor që ishin kundër parimeve dhe mësimave të nxjerra që për tri dekada kishin drejtuar politikën perëndimore karshi rajonit dhe që rrezikonin seriozisht destabilizimin e rajonit. Në të njëjtën kohë, Berlioni pati telashe me kërcënimet e brendshme të BE-së karshi politikës së zgjerimit të BE-së. Përballë daljes së Mbretërisë së Bashkuar nga BE-ja, partnerit të saj kryesor në mesin e "katërshes së madhe" (Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Italia) për avokimin e zgjerimit, në vitin 2018 qeveria Merkel provoi ta zëvendësonte Londrën me Parisin<sup>21</sup> – por pa sukses.

## ***Dështimi për të komunikuar: Merkeli dështon ta bëjë Macronin për vete (dhe anasjelltas)***

Testi i parë i partneritetit të ri të Berlinit për zgjerim me Francën ndodhi gjatë një takimi Merkel-Macron në mes të qershorit 2018, përpara një samiti evropian që do të vendoste për hapjen e negociatave të pranimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë<sup>22</sup>. Pasi u arrit një marrëveshje kompromisi në Berlin midis partive në pushtet që arritën të kapërcejnë rezistencën e brendshme të CDU-së kundër hapjes së bisedimeve me Shqipërinë dhe që përfshiu një dritë jeshile të kushtëzuar për hapjen e negociatave të pranimit me të dy vendet e Ballkanit Perëndimor, Merkeli hyri në takim me Presidentin francez e bindur se mund ta bënte për vete për propozimin e kompromisit gjerman.

---

<sup>19</sup> Bodo Weber, "The West's Dirty Mostar Deal: Deliverables in the Absence of a BiH Policy," DPC Policy Paper, Berlin, December 2020, available at: [http://www.democratizationpolicy.org/wp-content/uploads/2020/12/DPC-Policy-Note16\\_The-Wests-Dirty-Mostar-Deal.pdf](http://www.democratizationpolicy.org/wp-content/uploads/2020/12/DPC-Policy-Note16_The-Wests-Dirty-Mostar-Deal.pdf).

<sup>20</sup> Toby Vogel, Bodo Weber, "The EU's Perverse Agenda in Bosnia," EUObserver Op-Ed, March 4, 2021, available at: <https://euobserver.com/opinion/151110>.

<sup>21</sup> Intervistë me zyrtarë të qeverisë gjermane, pranverë 2018.

<sup>22</sup> Bodo Weber, "Contested, Yet Indispensable Leadership: Germany's Role in Macedonia's Euro-Atlantic Integration," Foundation Open Society Macedonia (FOSM), Skopje, February 2019, gjendet në: [https://fosm.mk/wp-content/uploads/publications/Germany\\_Role\\_in\\_Macedonia.pdf](https://fosm.mk/wp-content/uploads/publications/Germany_Role_in_Macedonia.pdf).

Por Berlini nuk i kishte bërë hesapet si duhet. Macron këmbënguli që të mos ndërmerren hapa të tjerë për integrimin në BE deri pas zgjedhjeve të ardhshme të Parlamentit Evropian të planifikuara në maj të vitit 2019. Në samitin e ardhshëm të Brukselit më 26 qershor, Franca, e mbështetur nga Danimarka dhe Holanda, bllokoi çdo vendim për propozimin përkundër mbështetjes së madhe nga shumica e shteteve anëtare të BE-së për hapjen e bisedimeve dhe përkundër rekomandimeve të Komisionit Evropian për hapjen e negociatave pa kushte. Kompromisi u gjet vetëm në momentin e fundit që "përcaktoi rrugën drejt hapjes së negociatave të pranimit në qershor 2019"<sup>23</sup> duke dokumentuar thjesht ndarjet e brendshme dhe në thelb duke iu dorëzuar pozicionit të Macronit. Shtyrja dëmtoi politikën e zgjerimit të BE-së të bazuar në kushtëzimin e reformave. Kjo goditje e rëndë ndaj besueshmërisë së Bashkimit dhe perspektivës së anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor ishte veçanërisht e rëndë në rastin e Maqedonisë së Veriut, ku një qeveri demokratike e udhëhequr nga opozita kishte ardhur në pushtet në vitin 2017 (me mbështetje të fortë amerikane, gjermane dhe të vendeve të tjera perëndimore) pas protestave të mëdha qytetare kundër kthesës autoritare të kryeministrit Nikolla Gruevski. Qeveria e re e Kryeministrit Zoran Zaev bëri lëshime të mëdha në Marrëveshjen e Prespës 2018 për të zgjidhur mosmarrëveshjen 27-vjeçare të emrit me Greqinë, me pritshmërinë që kjo t'i mundësonte përfundimisht vendit të ecë përpara drejt anëtarësimit në BE dhe NATO. Vetë Macroni nxiti këtë perceptim të lidhjes<sup>24</sup>. Në vitin 2019, Macroni arriti të shtynte vendimin për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut edhe më tutje<sup>25</sup>. Samiti Evropian i Tetorit 2019 përfundimisht u përbyll me bllokimin e plotë të vendimit për të dy vendet<sup>26</sup>. Presidenti Macron refuzoi të binte dakord për çdo përparim para se të reformohej metodologjia e anëtarësimit, duke e justifikuar veprimin e tij të njëanshëm me informata të rreme mbi procesin dhe metodologjinë ekzistuese të zgjerimit. Në të njëjtën kohë, Macroni bëri të njohur rezistencën e tij karshi liberalizimit të vizave për Kosovën, pavarësisht se vendi i kishte përmbushur prej kohësh të gjitha kushtet e BE-së. Siç shpjegoi një ekspert i politikës franceze për Ballkanin, "Macroni është përgjithësisht kundër zgjerimit, por pasi pozicionimi i hapur kundër atij vendimi do të vinte me çmim shumë të lartë, qasja e Parisit është të ngadalësojë procesin sa më shumë që të jetë e mundur"<sup>27</sup>.

---

<sup>23</sup> Council of the European Union, "Enlargement and Stabilisation and Association Process – Council Conclusions," Brussels, June 26, 2018; gjendet në: <https://www.consilium.europa.eu/de/press/press-releases/2018/06/26/council-conclusions-on-enlargement-and-stabilisation-and-association-process/>.

<sup>24</sup> In encouraging North Macedonia's voters to endorse the Prespa Agreement in September 2018, Macron told them "I am counting on you." Erwan Fouéré, "Macron's 'Non' to EU enlargement," CEPS, October 22, 2019. Gjendet në: <https://www.ceps.eu/macrons-non-to-eu-enlargement/>.

<sup>25</sup> Presidenti Macron i kërkoi me sukses Komisionit Evropian që të shtyjë publikimin e raporteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor nga prilli për në fund të majit 2019, një veprim që çoi në shtyrjen e mëtejshme të vendimit për dy vendet në qershor 2019, siç ishte rënë dakord në kompromisin e vitit 2018 për nëntorin 2019. Intervista me zyrtarë të qeverisë gjermane dhe politikëbërës dhe zyrtarë të BE-së, Berlin-Bruksel, 2018.

<sup>26</sup> "The EU Must Shift Out of Neutral in Its Enlargement Strategy: Championing Liberal Values Means Choosing Sides." DPC Policy Note, December 2019. gjendet në: [http://www.democratizationpolicy.org/pdf/DPC\\_Policy\\_Note\\_Enlargement\\_Strategy\\_Shift.pdf](http://www.democratizationpolicy.org/pdf/DPC_Policy_Note_Enlargement_Strategy_Shift.pdf).

<sup>27</sup> Intervistë me ekspertin francez për Ballkanin Perëndimor, korrik 2021.

Konfrontimi i hapur në Samitin Evropian të Tetorit 2019 ishte rezultat i zhgënjimit të Macronit me Merkelin për bllokimin e të gjitha nismave dhe propozimeve të tij për reformën strukturore të brendshme të BE-së gjatë dy viteve të mëparshme. Përpjekja e mëvonshme e qeverisë Merkel për të zgjidhur bllokimin e mëvonshëm bullgar të negociatave të pranimit të Maqedonisë së Veriut duke i bërë presion Sofjes për një marrëveshje kompromisi gjatë Presidencës gjermane të BE-së gjithashtu dështoi, përsëri sepse Macroni mbeti pasiv, duke sinjalizuar kështu indirekt mbështetjen e Parisit për qeverinë bullgare.<sup>28</sup>

## **Zbehja e fuqisë dhe ndikimit të Merkelit**

Nuk ishte vetëm kriza e përshpejtuar në Perëndim dhe zhvendosja e ekuilibrit brenda BE-së që dobësuan rolin drejtues të kancelares Merkel në integrimin e Ballkanit Perëndimor, por edhe dobësia e shtuar e udhëheqjes së brendshme politike të Merkelit në Gjermani pas vitit 2017 gjatë mandatit të saj të fundit. Në dritën e atij realiteti të ri, gjatë një vizite në mars të vitit 2018 që Vuçiqi i bëri Berlinit, në të cilën ai paraqiti planet e tij të ndarjes etnoterritoriale, Merkel i tha presidentit serb pas dyerve të mbyllura që të mos vinte më tek ajo me harta<sup>29</sup>. Por në të njëjtën kohë kancelarja gjermane u përmbajt nga dalja publike kundër idesë së shkëmbimit territorial dhe nga sulmi ndaj shefes së politikës së jashtme të BE-së Mogherini në publik. Dhe në konfliktin me Macronin për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, Merkel nuk luftoi shumë, duke zbuluar kufizimet e qasjes së saj politike menaxheriale.

Mungesa e propozimeve serioze për reformën e brendshme, strukturore të BE-së, duke u fokusuar te parandalimi i shteteve të tjera anëtare për t'i shtyrë propozimet e tyre, e la Merkelin pa peshë të mjaftueshme negociuese kundrejt Macronit për zgjerimin, që vazhdonte të ishte çështje dytësore politike për presidentin francez<sup>30</sup>. Stili reaktiv i lidershit të Merkelit në BE gjithashtu doli kundër saj gjatë krizës evropiane të refugjatëve, kur mungesa e masës kritike të shteteve anëtare për të mbështetur standardet e BE-së për relokimin e refugjatëve dhe azilkërkesve e detyroi atë të vepronte në mënyrë të njëanshme. Dhe në Bruksel, kandidatja e Merkelit për Presidenten e re të Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, pasi mori detyrën në vjeshtën e vitit 2019, mori vendime për personelin që binin ndesh me politikën e zgjerimit të Merkelit – siç ishte emërimi i aleatit të Victor Orbánit, Olivér Várhelyi, si Komisioner i ri për Fqinjësi dhe Zgjerim, i cili që atëherë e barti filozofinë politike joliberalë të ish-mësuesit të tij hungarez në zyrën e tij të re evropiane.<sup>31</sup>

---

<sup>28</sup> Ibid.

<sup>29</sup> Intervistë me zyrtarin e qeverisë gjermane, prill 2018.

<sup>30</sup> Intervista me zyrtarë të qeverisë gjermane, Berlin, 2018-19, maj 2021.

<sup>31</sup> Intervista me deputetët e CDU-së, politikëbërësit e BE-së, Berlin-Bruksel, vjeshtë 2019, dimër 2019-20.



## ***E ardhmja e zgjerimit pas Merkelit***

Largimi i kancelares Merkel pas zgjedhjeve të shtatorit për Bundestagun gjerman do të sjellë fundin e një epoke dhe nisjen e një epoke të re. Çështja e vetme me të cilën përfaqësuesit e qeverisë, politikëbërësit dhe vëzhguesit politikë në Berlin pajtohen aktualisht është se mjedisi i sotëm politik në Gjermani është më i hapur ndaj rezultateve të ndryshme potenciale nga sa është parë në dekada, dhe se çfarëdo që të jetë rezultati i zgjedhjeve parlamentare dhe negociatave të mëvonshme të koalicionit, Merkeli do të lërë pas një hendek të madh lidhshipi në BE, duke përfshirë politikën gjermane dhe atë të BE-së (zgjerimit) karshi Ballkanit Perëndimor. Edhe nëse pasardhësi i saj është i përkushtuar në mënyrë të barabartë për zgjerimin, atij do t'i mungojë besimi dhe reputacioni i favorshëm që Merkel i fitoi gjatë viteve të bashkëpunimit me aktorët rajonalë dhe udhëheqësit politikë në Ballkanin Perëndimor. Tashmë, vendimi i CDU-së në janar të vitit 2021 për presidentin e ri ishte krejtësisht i paparashikueshëm. Por ajo që kanë të përbashkët të tre kandidatët – Armin Laschet, Kryeministri i shtetit të Nordrhein Westfalen, ish-kundërshtari i Merkelit Friedrich Merz, dhe deputeti dhe kryetari i Komitetit të Politikës së Jashtme të Bundestagut, Norbert Röttgen – është se secili ka ose pak ose nuk ka fare përvojë me Ballkanin Perëndimor, dhe mungesë interesimi për rajonin – dhe, rrjedhimisht, mungesë interesimi për zgjerimin. Laschet, kandidati dominues i cili gjithashtu triumfoi më pas në garën e brendshme të partisë konservatore simotër për t'u bërë Spitzenkandidat, nuk ka profil të qartë të politikës evropiane dhe të jashtme. Në rastin më të mirë, ai sinjalizon vazhdimësinë e politikës së epokës së Merkelit<sup>32</sup>. Çdo lidhje me angazhimin karshi perspektivës së vendeve anëtare ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor në programet e ndryshme zgjedhore të partive është edhe më pak e theksuar se në zgjedhjet e mëparshme, me përjashtim të dukshëm të të Gjelbërve.

Të Gjelbrit, me Spitzenkandidatin e tyre, Annalena Baerbock, janë tradicionalisht partia parlamentare më proevropiane në Gjermani. Përveç një përkushtimi të fortë për reformën strukturore të brendshme të BE-së, programi<sup>33</sup> zgjedhor i të Gjelbërve përmban një përkushtim eksplicit për zgjerimin e BE-së. Ai trajton të gjitha sfidat kryesore rajonale: negociatat Kosovë-Serbi dhe dhënien e liberalizimit të vizave, rendin jofunksional kushtetues të BeH dhe hapjen e negociatave të pranimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Sondazhet e kryera në vitin 2020 dhe gjysmën e parë të vitit 2021 i nxjerrin të Gjelbrit në vendin e dytë, megjithëse disa sondazhe në pranverën e hershme i nxorën të parët në zgjedhjet e shtatorit.

<sup>32</sup> "Armin Laschet wants to lead Europe. Not everyone thinks he's up to it," Politico.EU, August 9, 2021, gjendet në: <https://www.politico.eu/article/germany-armin-laschet-cdu-chancellor-europe-leader/>.

<sup>33</sup> Bündnis 90/Die Grünen, „Deutschland. Alles ist drin. Bundestagswahlprogramm 2021," June 2021, p. 226, gjendet në: <https://www.gruene.de/artikel/wahlprogramm-zur-bundestagswahl-2021>.

Ky skenar flet për shumë mundësi që të Gjellbrit të jenë pjesë e qeverisë së ardhshme, me shumë gjasa për një koalicion gjellbër–zi/zi–gjellbër me CDU–CSU. Sidoqoftë, sondazhet më të fundit treguan një rënie të të Gjellbërve, duke dalë në vendin e tretë pas CDU–CSU dhe Socialdemokratëve. Një rezultat i tillë zgjedhor do të linte vetëm një opsion të mundshëm të koalicionit që do të përjashtonte të Gjellbrit. Baerbock, bashkëkryetare e partisë, ka një ekspertizë të politikës së jashtme dhe sipas disa burimeve “Ballkanin Perëndimor e ka në radarin e saj”<sup>34</sup>. Është sekret i hapur në Berlin se ajo ia ka vënë syrin ministrisë së jashtme nëse partia e saj bëhet partneri më i ri i koalicionit të ardhshëm. Kështu, deputetët gjermanë nga kampe të ndryshme politike të përkushtuar ndaj Ballkanit Perëndimor dhe zgjerimit të BE–së i kanë vënë shpresat e tyre fillimisht te të Gjellbrit për të kapërcyer hendekun që do të lërë pas largimi i Merkelit.<sup>35</sup>

---

<sup>34</sup> Intervistë me përfaqësuesit e partisë së Gjellbër, Berlin, vjeshtë 2020 dhe pranverë 2021.

<sup>35</sup> Intervista me deputetët e Gjellbër dhe CDU–CSU, Berlin, vjeshtë 2020 dhe pranverë 2021.

## **Përfundime dhe rekomandime**

Pas një dekade e gjysmë sa Angela Merkel dominoi skenën politike në Gjermani dhe në Evropë, roli i saj ishte qenësor në mbajtjen gjallë të politikës së zgjerimit të Bashkimit Evropian karshi Ballkanit Perëndimor. Roli i saj ishte gjithashtu vendimtar në BE dhe më gjerë në Perëndim, duke trajtuar konfliktet e pazgjidhura nga epoka e stabilizimit të menjëhershëm të pasluftës, ku ai midis Kosovës dhe Serbisë ishte më i spikaturit. Sidoqoftë, lidhshipi reaktiv i Merkelit dhe stili politik menaxherial, pa ndonjë strategji a vizion politik afatgjatë, përfundimisht kufizoi ndikimin dhe fuqinë e saj. Kombinimi i të metave të Merkelit dhe krizës/përçarjes më të gjerë të Perëndimit pas zhvillimeve të viteve 2015/2016 bëri të mundur përmbysjen e suksesit fillestar historik në dialogun politik të udhëhequr nga BE-ja mes Kosovës dhe Serbisë. Ky ndryshim siguroi një hap përpara nga ngërçi i përgjithshëm demokratik në vendet e Ballkanit Perëndimor – të mirëpritur e të nxitur nga elitat vendore – dhe për ndryshimin që Vuçiqi bëri nga një qëndrim deklarativ politik proevropian drejt një pushteti autoritar dhe autokratik të sundimit individual në Serbi. Merkelu gjithashtu nuk arriti të bindte dhe parandalonte Presidentin francez Macron të rrezikojë të ardhmen e zgjerimit, duke kërcënuar kështu stabilitetin dhe sigurinë afatgjatë të Ballkanit Perëndimor, dhe të Evropës në përgjithësi.

Ndër çështjet që kërkojnë vëmendje pasi kancelarja Merkel të largohet nga detyra, janë negociatat Kosovë-Serbi të drejtuara nga BE-ja për një marrëveshje përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe detyruese. Rinisja, e nxitur nga Berlioni dhe Washingtoni, është e nevojshme në vitin 2022, pasi zyrtarët qeveritarë dhe politikëbërësit pajtohen se asnjë përparim i vërtetë nuk është i mundur në vitin 2021<sup>36</sup>. Për të ardhmen e zgjerimit në kuptimin më të gjerë, një zyrtar i qeverisë gjermane vëren se “ne kemi nevojë për një përparim në vitin 2022 me Macronin për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë – përndryshe zgjerimi përfundimisht do të jetë i vdekur”, duke treguar kështu nevojën që qeveria dhe kancelari i ardhshëm gjerman të gjejnë një mënyrë për të ndikuar te Presidenti francez.<sup>37</sup>

Largimi i kancelares Merkel do të lërë një hendek të madh në politikën e Gjermanisë dhe BE-së karshi Ballkanit Perëndimor. Por kjo gjithashtu paraqet një mundësi për të ringjallur procesin e brendshëm të reformës së BE-së dhe për të rikalibruar politikën e zgjerimit të Bashkimit Evropian dhe koordinimin me ShBA-të dhe aleatët e tjerë. Këtu hyn zbatimi i iniciativave të ndryshme për të rikthyer çështjet e pazgjidhura të statusit në rajon, ndër më kryesoret është kontestimi i vazhdueshëm dhe cënimi i statusit të Kosovës si shtet i pavarur dhe subjektivitetit të saj ndërkombëtar nga ana e Serbisë – drejtpërdrejt dhe tërthorazi siç dëshmohet te ndërhyrja gjithnjë më e madhe në Malin e Zi. Megjithatë, ekziston potenciali për ndryshime pozitive, ndërsa qeveria e ardhshme gjermane ka potencial për të përfituar nga kjo mundësi që buron kryesisht nga të Gjellbrit gjermanë.

---

<sup>36</sup> Intervista me politikëbërës dhe zyrtarë qeveritarë, Berlin, pranverë 2021.

<sup>37</sup> Intervistë me zyrtarin qeveritar, qershor 2021.



## Rekomandime

Ky dokument është shkruar me fokus te publiku kosovar. Kësisoj, ndërsa grupi i parë i rekomandimeve ka për qëllim politikën gjermane për tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor, i dyti i drejtohet posaçërisht Prishtinës.

### *Qeverisë së ardhshme gjermane*

Për të shmangur kolapsin përfundimtar të politikës së zgjerimit të BE-së dhe për të rikthyer politikën e saj drejt Ballkanit Perëndimor, koalicioni i ardhshëm qeveritar gjerman duhet të ndërmarrë një varg hapash vendimtarë politikë në fillim të mandatit të vet, veçanërisht në vitin 2022:

- Berlioni duhet të nisë negociatave serioze me anëtarët e BE-së, duke filluar me Parisin, për reformën e ardhshme të brendshme të BE-së për të përfshirë propozimet e veta me fokus të veçantë të të ashtuquajturat shtetet anëtare joliberalë në të cilat ekziston kriza e sundimit të ligjit dhe demokracisë.
- Nga fillimi i vitit 2022, veçanërisht pas zgjedhjeve presidenciale franceze, Berlioni do t'i duhet të angazhohet seriozisht me Parisin për të ardhmen e zgjerimit, për zhblokimin e negociatave të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë dhe për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës.
- Qeveria e re gjermane dhe partitë e saj në pushtet duhet t'u komunikojnë qytetarëve se është në interesin më të mirë të Gjermanisë të hapë zgjerimin drejt vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe se është e pashmangshme që BE-së do t'i duhet të ndërmarrë njëkohësisht reformën e brendshme dhe zgjerimin.
- Berlioni do të duhet të trajtojë ngecjen demokratike në vendet e Ballkanit Perëndimor duke forcuar sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit në politikën e zgjerimit të BE-së.
- Berlioni duhet të ndërmarrë një nismë brenda Këshillit Evropian për një strategji afatgjatë të politikave të BE-së për Bosnjë dhe Hercegovinën, me ndryshimet kushtetuese në thelbin e saj.

- Berlina duhet të kapë nismën dhe t'i drejtohet administratës së Bidenit në fillim të vitit 2022 për hartimin e një strategjie të re transatlantike të Ballkanit Perëndimor që përfshin zgjerimin e BE-së dhe NATO-s.
- Berlina duhet t'i drejtohet administratës së Bidenit në fillim të vitit 2022 për një nismë të përbashkët për të rifilluar negociatat Kosovë-Serbi për të arritur një marrëveshje përfundimtare, gjithëpërfshirëse brenda një kornize negociuese të bazuar në parimet burimore të dialogut politik 2012-2013
- Berlina duhet t'i nxisë anëtarët për të rikthyer besueshmërinë e politikës së zgjerimit të BE-së dhe perspektivës së anëtarësimit, dhe pastaj të ringjallë Procesin e Berlinit si mjet për të nxitur bashkëpunimin rajonal që nuk kufizohet vetëm brenda projekteve të infrastrukturës, dhe ta ruajë lidhshypin gjerman në këtë proces.

### *Qeverisë së Kosovës*

Në dritën e ndryshimit të ardhshëm në udhëheqjen gjermane, qeveria kosovare duhet të përgatitet për të avokuar dhe për t'u angazhuar në mënyrë efektive me qeverinë e re gjermane për të avancuar interesat e Kosovës dhe rajonit më të gjerë të Ballkanit Perëndimor:

- Prishtina duhet t'i drejtohet herët koalicionit të ri qeverisës në Berlin për të avokuar për vazhdimësinë e udhëheqjes gjermane të BE-së sa i përket politikës së zgjerimit karshi Ballkanit Perëndimor.
- Prishtina duhet të avokojë në mënyrë të vazhdueshme në kryeqytetet e BE-së – për të zhbllokuar liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës menjëherë pasi zgjedhjeve presidenciale franceze – t'u përshtatet specifikave të situatës pas Merkelit në Gjermani dhe Bashkim Evropian.
- Prishtina duhet të avokojë që Kancelari dhe qeveria e ardhshme të marrin iniciativën, së bashku me Presidentin Biden dhe administratën e tij, për të rinisur negociatat për një marrëveshje përfundimtare, gjithëpërfshirëse me Serbinë, të bazuar në parimet dhe synimet e përcaktuara qartë.
- Nëse rinisin negociatat, Prishtina duhet të sinjalizojë gatishmërinë e saj për të bërë kompromis me Beogradin në këmbim të garancive të Gjermanisë dhe ShBA-ve se marrëveshja do të çojë në sovranitet të plotë dhe integritet territorial të Kosovës dhe në përparim thelbësor në arritjen e subjektivitetit të plotë ndërkombëtar të bazuar në bashkëpunim dhe mbështetje proaktive të Beogradit.

**Katalogimi në botim – (CIP)**  
**Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”**

321(4)(06)

Weber, Bodo

E ardhmja e politikës së zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor  
pas Merkelit : analizë e Politikave / Bodo Weber. - Prishtinë : Demokraci për  
zhvillim, 2021. - 28 f. ; 24 cm.

**ISBN 978-9951-832-16-8**

## Instituti Demokrasi për Zhvillim

Instituti Demokrasi për zhvillim (D4D) u themelua në prill të vitit 2010 nga një grup analistësh që shqetësoheshin gjithnjë e më shumë se ushtrimi i shtetndërtimit po shpërfillte demokracinë.

Vizioni i D4D-së është të promovojë qytetari aktive dhe të arsimuar që merr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe përdor arenën publike të përfaqësimit dhe vendimmarrjes për të menduar dhe për të ndërtuar konsensus mbi shpërndarjen e burimeve që është efikase, e zgjuar, afatgjatë dhe që sjell zhvillim të barabartë.

D4D ndikon në politikat specifike, promovon qasje ndërsektoriale për zgjidhjen e problemeve dhe adreson rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime në shtuara dhe vepron me efektivitet maksimal për të promovuar plotësisht stabilizimin e Kosovës dhe zhvillimin demokratik.

## Democratization Policy Council

Misioni i DPC-së është të bëjë presion mbi demokracitë e krijuara dhe të reja dhe institucioneve transnacionale dhe ndërkombëtare për të ndjekur politika të bazuara në vlerat dhe parimet liberale demokratike brenda fushës së angazhimeve dhe përkushtimeve të tyre ndërkombëtare.

Përmes hulumtimit, analizës, avokimit dhe angazhimit publik, DPC-ja kërkon të tërheqë vëmendjen e politikëbërësve, ligjvënësve dhe shoqërisë civile në shkeljet e lirive brenda kornizës demokratike.

DPC-ja synon të kërkojë përgjegjësi nga politikëbërësit në bazë të historisë së tyre liberalo-demokratike, të propozojë përgjigje të përshtatshme dhe konkrete të politikave ndaj ngërçit demokratik dhe të zhvillojë konstituencë popullore me bazë të gjerë për promovimin dhe mbështetjen e demokracive liberale.

Mbështetur nga:



ISBN 978-9951-832-16-8



9 789951 832168